



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 618/6 Prot.

Tiranë, më 25.09.2023

V E N D I M

Nr. 186, datë 25.09.2023

Mbështetur në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 80, datë 22.05.2023, e A.K kundër Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a (OSHEE), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike¹”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Nga viti 1998-2023 kam jetuar me bashkëshorten në një shtëpi e cila ka qenë me ish pronar. Në muajin shkurt 2023, shtëpia i ka kaluar pronarit dhe Bashkia më ka strehuar në një banesë tjetër e cila është në pronësi të saj, pranë konviktit “Trajtimi i studentëve”. Problemi qendron tek mospasja e energjisë elektrike, pasi nga OSHEE më kërkohet³ që të paguaj një shumë prej 21.765 lekë për vendosjen e matësit dhe unë nuk kam mundësi që të paguaj këtë shumë, pasi gëzoj statusin si familje në nevojë dhe të ardhurat mujore janë 3.703 lekë në muaj”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe të merren masa për lidhjen e kontratës dhe vendosjen e matësit të energjisë.

¹ Referuar Vërtetimit datë 03.04.2023, të lëshuar nga Bashkia Korçë, vërtetohet se A.K trajtohet me ndihmë ekonomike, në shumën 3.703 lekë.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

³ Referuar dokumentit: Customer intimation acknowledgement, No Series: L 120230511261, datë 17.05.2023.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 3, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se:

“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato

- a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;*
- b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.*

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:

- c) kontributin dhe mundësinë për të përfutuar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;...”*

Neni 7 i LMD-së⁴, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të

⁴ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/4 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 618/1, datë 24.05.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion nga OSHEE sh.a dhe OSHEE Korçë, për ankesën e bërë nga A.K si dhe ka kërkuar aktet e poshtë cituara:
 - Informacion i hollësishëm mbi mundësitë eksistuese për lidhjen e një kontrate të re furnizimi ndërmjet A.K dhe OSHEE sh.a dega Korçë;
 - Informacion nëse janë lidhur kontrata të njëjta apo të ngjashme me familje/abonentë të tjerë, në pamundësi financiare si subjektet ankues. Nëse po, kopje të këtyre akteve.

Me shkresën nr. 4080/1, datë 30.05.2023, OSHEE sh.a në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“OSHEE SH.A është person juridik që funksionon si shoqëri aksionere, organizimi i së cilës bëhet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. OSHEE është regjistruar si person juridik, në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me Numër Unik të Identifikimit (NIPT) K72410014H, në bazë të Vendimit nr. 38587, datë 19.06.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

Ndër të tjera, në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, Enti Rregullator i Energjisë ka miratuar me Vendimin nr.166, datë 10.10.2016, të Bordit të Komisionerëve të ERE, e ndryshuar me Vendimin nr. 177, datë 08.11.2016 të Bordit të Komisionerëve të ERE “Rregulloren për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes”, të cilën mund ta konsultoni në faqen zyrtare të internetit të ERE.

Neni 4.2 i kësaj rregullore përcakton kostot që lidhen me shërbimet që do të kryhen nga “OSHEE Group” SH.A. Gjithashtu referuar nenit 4.3 të kësaj rregulloreje, “OSHEE Group”, zbaton praktikën e pagesës së plotë në avancë për të gjitha lidhjet e reja apo modifikimin e lidhjeve ekzistuese.

Shoqëria mirëkupton situatën me të cilën përballet A.K si dhe shqetësimin e paraqitur nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, por siç është referuar edhe më sipër, shoqëria

“OSHEE Group”, vendoset në pozitën e zbatimit të dispozitave të Rregullores për Lidhjet e Reja në sistemin e shpërndarjes sipas kushteve të përcaktuara në këtë akt rregullator, si çdo entitet tjetër shtetëror që ushtron veprimtarinë e vet në kushtet e rregullimit”.

Me shkresën nr. 88/1, datë 05.06.2023, OSHEE Drejtoria Rajonale Korçë, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Mbështetur në Rregulloren e Kompanisë OSHEE çdo individ apo institucion paraqitet pranë zyrave të Kujdesit ndaj Klientit të Kompanisë për të aplikuar për Lidhje të Re.*

Pas dorëzimit të dokumentacionit dhe miratimit të Lidhjes së Re për aplikantin nga Drejtoria e Ofrimit të Rrjetit OSSH miratohet dhe Preventivi i Pagesës (bashkëlidhur) i cili duhet të paguhet nga aplikanti për marrjen e shërbimit dhe pajisjeve (sistem matje, linjë furnizimi, pajisje me kontratë energjie, etj).

Sa i përket kërkesave nga ana juaj:

- 1. Përjashtime lidhur me pretendimin e ngritur nga ankuesi.*

Nga ana e OSSH nuk mund të bëhet përjashtim lidhur me pagesën e Preventivit për lidhje të re, pasi preventivi paguhet në vlerën totale të tij.

- 2. Informacion i hollësishëm mbi mundësitë ekzistuese për lidhjen e një kontrate të re furnizimi nëpërmjet A.K dhe OSHEE sh.a dega Korçë.*

Nga ana jonë është krijuar mundësi për lidhjen e një kontrate të re furnizimi, pra preventivi i pagesës është pikërisht për lidhjen e kontratës së re të furnizimit me energji elektrike, ndërmjet OSSH sh.a dhe A.K.

- 3. Informacion nëse janë lidhur kontrata të njëjta apo të ngjashme me familje/abonentë të tjerë në pamundësi financiare si subjekti ankues.*

Sa i përket informacionit të kërkuar ju bëjmë me dije se nuk ka asnjë rast për të cilin të jetë lidhur kontratë e re furnizimi për energji elektrike pa kryer më parë pagesën e preventivit si një nga shkallët e vijimit të procedurës për pajisjen me kontratë energjie për abonentin”.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 618/3, datë 08.08.2023 njoftoi palët duke ftuar në seancë dhe Bashkinë Korçë, për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 22.08.2023, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces, si dhe kërkoi informacion dhe kopje të dokumentacionit, si më poshtë:
 - Informacion si vepron Bashkia me familjet e tjera që trajtohen me ndihmë ekonomike, që janë strehuar nga Bashkia dhe janë në të njëjtat kushte me ankuesin, lidhur me sigurimin e furnizimit me energji elektrike.**

- Informacion mbi masat e marra nga Bashkia dhe Këshilli Bashkiak Korçë për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike apo kategori të tjera dhe që nuk kanë mundësi ekonomike për të përballuar pagesën e lidhjes së kontratës për furnizim me energji elektrike apo për pagesën e konsumit të energjisë elektrike.
- Kopje të marrëveshjes së strehimit, mes Bashkisë Korçë dhe A.K.

Seanca u zhvillua në datë 22.08.2023, vetëm me praninë e subjektit OSHEE sh.a, pasi ankuesi dhe Bashkia Korçë megjithëse kishin marrë njoftim nuk u paraqitën në seancën dëgjimore.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqesuesi i OSHEE sh.a⁵ i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Me shkresën nr. 6099/1, datë 24.08.2023, Bashkia Korçë, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“A.K, i kategorisë i pastrehë, nuk ka asnjë marrëveshje për strehim me Bashkinë Korçë. Ambienti ku ai aktualisht banon, është zgjedhja e tij. A.K ka bërë aplikim online përmes portalit e-albania me nr. BS 120920220006, datë 12.09.2022, për të përfutur nga programet e strehimit social dhe jemi në pritje që ai të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm”*.

Në vijim, subjekti ankues nëpërmjet procesverbalit të mbajtur në datë 06.09.2023, nga ana e specialistes së zyrës së Komisionerit në Korçë, ka kërkuar pushimin e shqyrtimit të ankesës pasi ka zgjidhur problemin duke paguar kontratën për vendosjen e matësit.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar përcaktohet se: *“Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”*.

Në nenin 90, *“Përfundimi i procedurës administrative”*, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, parashikohet se: *“3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”*. Ndërsa, në nenin 94 *“Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës”*, pikat 1 dhe 3, të Kodit të Procedurave Administrative, parashikohet si vijon: *“1. Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.3. Në çdo rast, tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës nuk ndikon në vazhdimin e tij, nëse organi publik çmon se vazhdimi i procedurës është në interes publik, me përjashtim të rasteve kur procedura është e tillë që mund të fillojë vetëm me kërkesën e palës”*.

Bazuar në dispozitat e mësipërme, si dhe kërkesën për tërheqje nga ankesa të paraqitur nga ankuesi në datën 06.09.2023, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës nr.

⁵ Autorizuar me shkresën nr. 8425, datë 16.08.2023

80, datë 22.05.2023, të paraqitur nga A.K, kundër OSHEE sh.a, nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se ankuesi është tërhequr nga ankesa dhe nuk identifikohet ndonjë interes publik që do të legjitimonte vazhdimin e procedurës, nga ana e këtij organi publik⁶.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a” dhe pika 2, nenin 33 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, nenin 90, pika 3 dhe nenin 94, pikat 1 dhe 3, të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 80, datë 22.05.2023, paraqitur nga A.K, kundër Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, për shkak se pala ankuese është tërhequr nga ankesa.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

⁶ Për analogji referojmë Vendimet nr. 194, datë 17.10.2022 dhe nr. 177, datë 11.09.2023 të Komisionerit.